



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.29.04.2026, në orën 11:00, nësallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Albanë Shillova Shalaku (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Bardhyl Mjekiqi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Mervete Shala (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Abdylrahman Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Enver Gashi (LDK), Fidan Ahmeti (LDK), Labinot Mirena (LDK), Linda Bekteshi, (LDK), Muhamet Preniqi (LDK), Vlora Mjekiqi Kabashi (LDK), Goran Dancetovic (SL), Biljana Spasic (SL) dhe Dorentina Mustafa (AAK).

Të pranishmit tjerë: Kryetari i Komunës, Halil Thaqi, Berat Gashi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, zyrtarët komunal, përf. e OSBE-së, dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesuesi cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DPUKP me nr. 05-104/02-10071/26 për shfuqizimin e shpalljes/publikimit të Listës së Përgjithshme dhe të veçantë të Pronave të paluajtshme të Komunës – të planifikuara për dhënie në shrytëzim për vitin 2026
4. Raporti financiar i shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2026
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DSHMS-së, me nr.08-104/02-10362/26 për iniciimin e procedurës për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal të Obiliqit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në nivel komunal
6. Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës me nr.02-060-01-6636-26 për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve të NPL "Kastrioti" SH.A.
7. Shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Komunës me nr.01-060/01-6641/26 për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve të kompanisë KRM "Pastrimi"
8. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës. Po ashtu, i njoftoi anëtarët e Kuvendit Komunal se në mbledhjen e KPF-së, të mbajtur me dt.24 prill janë shtuar edhe 4 pika të reja në rend dite, të cilat do të renditen nga pika 4 ndërsa tjerat vijnë sipas radhës. Pikat që do të shtohen në rend dite për këtë mbledhje janë:

-Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për subvencionimin e transportit publik në Komunën e Obiliqit.

-Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DEFZH-së, për bartjen e buxhetit, të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026.

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për miratimin e Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores me nr.03 kthye për 2024 me të cilën është plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja nr.02 kthye për 2023 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

-Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale NPL “Kastrioti”.

Enver Gashi – Unë kam një vërejtje te bartja e buxhetit, për arsye se ne e kemi në pikën 4 raportin financiar dhe së pari duhet të jetë raporti financiar, pastaj bartja e buxhetit, sepse ky buxhet është edhe në financa, e jo njëherë po e bëjmë bartjen, pastaj raportin financiar.

Kryesuesi – Në këtë rast rendi i ditës nuk diskutohet, vetëm miratohet dhe kemi me pasë mundësi me diskutuar mjaftueshëm.

Miratohet rendi i ditës me 15 vota për, 3 vota kundër dhe 2 vota abstenim, me plotësim ndryshimin e cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Fitore Hashani.

Kryesuesi – Meqë mungon sot znj.Fitore Hashani, e lus grupin e LDK-së, kush do ta ketë rolin e saj sot.

Linda Bekteshi – Unë sot do ta zëvendësoj shafen e grupit parlamentar.

Pika 2 e rendit të ditës

Bajram Hashani - Paraqiti 2 vërejtje në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar sepse aty ku kam thënë se shkolla ka marrëveshje me KEDS-in në procesverbal shkruan KEK-u, por duhet të jetë “KEDS”-i. Vërejtja e dytë është kur z.Labinot thotë a është z.Xhafer në LDK dhe aty figuron emri i z.Abdyrrahman.

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 20 vota, për me vërejtjet e cekura më lartë.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DPUKP-së, për shfuqizimin e shpalljes/publikimit të Listës së Përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës – të planifikuara për dhënien në shrytëzim për vitin 2026.

Fjolla Nasufi – Pasi që drejtori e ka dhënë sqarimin e mjaftueshëm, ne e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

Linda Bekteshi – Ne nuk kemi diçka për të thënë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës me 18 vota, për dhe 2 vota, abstenim morën Vendim për miratimin e Shfuqizimit të shpalljes/publikimit të Listës së Përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës – të planifikuara për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për subvencionimin e transportit publik në Komunën e Obiliqit. Para se të hapë debatin, ftoi drejtorin e DEFZH-së që të shpjegojë çështjen e subvencionimit se sa do t'i kushtojë Komunës dhe gjërat tjera.

Besnik Krasniqi – Ne kemi bashkëpunuar me drejtorin e DSHPE-së, në këtë drejtim dhe subvencionimi mujor kushton 27,147.31 euro ndërsa vjetor është 325,766.74 euro. Këto mjete do të merren nga kategoria e subvencioneve.

Fjolla Nasufi – E mbështesim subvencionimin e transportit publik i cili është në interes të qytetarëve.

Muhamet Preniqi - Unë e kisha sugjeruar Kryetarin të mos vazhdoj tutje lidhur me subvencionimin derisa të kthehet nga Ministria, vendimi dhe kisha kërkuar sqarim se qysh i ka llogaritur këto subvencionime ,paushall apo me kilometër, qysh e keni llogaritur.

Kryesuesi – Z.Preniqi, nuk e di për cilin vendim e keni fjalën.

Muhamet Preniqi – Vendimi që pritet me u kthyer nga MAPL-ja.

Kryesuesi – Vendimi nga MAPL-ja, tashmë është transferuar në Ministrinë e transportit. Edhe ky vendim kur nxirret, kërkon shqyrtimin e ligjshmërisë, por nuk është ndonjë telashe edhe nëse kthehet; ne jemi njerëz edhe mundemi me gabu. Qëllimi është shumë i mirë dhe ne shpresojmë se do ti rregullohet qytetarëve gjendja në transportin publik, që besoj se edhe ju pajtoheni që ka nevoja të mëdha.

Muhamet Preniqi – Ka nevojë edhe më shumë.

Kryesuesi – Sa i përket subvencionimit, fjalën ia japë drejtorit të shërbimeve publike.

Valon Svirca - Sa i përket asambleistit që e përmendi që është matë paushall te kjo pjesa e linjave dhe itinerareve është formuar Komisioni dhe është me kilometra për nisje, ashtu siç e keni marrë materialin janë kilometrat e saktë. Është punuar dhe rekord i kanë bërë matjet për çdo nisje, në çdo pjesë ku ndalet në stacion deri te përfundimi janë me kilometra të sakta dhe nuk ka kurgjë paushall. Edhe te Komisioni për itinerare dhe linja dhe te Komisioni për subvencionimin e linjave.

Linda Bektësia - A bën një sqarim me na dhënë neve drejtori se qysh e ka mendu linjën e transportit ndryshimin e orareve, kur dihet se këto orare janë qe 30 vite, e më shumë. Neve, po na intereson qysh e keni mendu me i'a ndërru orarin dhe a jeni kordinu me operatorët që operojnë në Obiliq për këtë punë.

Valon Svirca – Sa i përket orareve pothuajse 90 % janë që nuk kanë lëvizë duke i përjashtuar fshatrat që tashmë i kanë linjat e reja për transport. Këtu, gjithmonë jemi kordinu e kanë masën mbrojtëse dhe gjithçka është në rregullë sa i përket orareve dhe linjave. Pra, 90 % janë që nuk kanë lëvizë vetëm ato që i kemi shtu në ora 11 që është nisja e fundit dhe këto janë oraret e reja.

Enver Gashi - Një pyetje për juve, ose drejtorit të shërbimeve publike për Dardhishtë, gjysmën e fshatit e keni lënë anash edhe pse janë stacionet, edhe pse kanë qenë vijat. Unë po çuditem edhe prej drejtorit të infrastrukturës, edhe anëtarët e Kuvendit që janë këtu prej Dardhishtës e kanë lënë, edhe prej Kryetarit se Kryetari ka ditë me ardhë në mëhallën time aty dhe me u mburrë se isha në mëhallën e Gashëve dhe tash kemi mbetë jashtë transportit publik.

Kryesuesi – Me atë që është cekë në dokumentacion nuk është cekë se cila lagje do të përfshihet dhe është cekë se do të përfshihet Dardhishta, e kam parë në disa itinerare.

Valon Svirca – Sa i përket Dardhishtës, ka vite që nuk ka transport pothuajse fare, përveç një që është për me shku; prej Obiliqit në Fushë Kosovë. Tash, është Dardhishtë-Obiliq-Prishtinë edhe arsyeja pse nuk e ka mbajtë itinerarin e din Enveri dhe e din krejtë pushteti për shkak se nuk ka pasë udhëtarë, nuk ka pasë mjete me i subvencionue. Udhëtarë ka pasë, por nuk ka mund me mbajtë vijën.

Abdyrrahman Krasniqi – Fillimisht e përgëzoj drejtorin për transportin publik dhe për iniciativën që është marrë si dhe për subvencionimin sepse e dimë se aty ka qenë shumë e domosdoshme, por edhe për gjithëpërfshirjen edhe Kryetarin. Mirëpo, unë si banor i fshatit Breznicë, ndoshta e kam një kërkesë shtesë që është e vërtetë se janë bërë transporte të reja, por edhe nisje të reja. Ndoshta kishte me qenë mirë me i shiku nisjet e fshatit Breznicë, për shkak se autobusët e mëdhenj nuk munden me qarkullue për Koskovik me dalë në Barilevë dhe me hy në Baimoc, Si iniciativë fillimisht le te provojnë, por kushtet rruga nuk i plotëson Kryetar. Edhe kam kërkesë edhe prej operatorëve, por edhe prej qytetarëve sepse ka me pasë edhe vonesa të mëdha ose nëse, takohet për shembull një autobus me një kamion mbeten të bllokuar në gjysmë të rrugës. Unë jam pro dhe e mbështesë iniciativën, ndoshta me një rishikim në të ardhmen sepse është problematike kjo çështje.

Labinot Mirena - Unë besoj se është një hap i jashtëzakonshëm çështja e transportit që iu bëhet qytetarëve të Komunës së Obiliqit. Unë vijë në këtë pjesën këndeje nga Sitnica, që i thojnë dhe fshati Grabofc për me ardhë në Obiliq, është dashtë me shku në Fushë Kosovë dhe prej Fushë Kosovës në Prishtinë, pastaj prej Prishtinës me ardhë në Obiliq. Mendoj se është turp ne mos me përkrahë një vendim që unë e mbështesë, kam qenë pro dhe vazhdoj me qenë pro për të gjitha vendimet e mira që i marrim karshi qytetarëve të Komunës së Obiliqit.

Kryesuesi - Fjalën ia dha drejtorit të infrastrukturës lokale.

Naïm Shalaku – Sa i përket pyetjes që e bëri z.Gashi, ka qenë mirë ai atëherë sa ka qenë shef i grupit qysh e ka pasë ajo parti emrin LDK apo IQO me bë këtë pyetje më heret. Unë jam i kënaqur me këtë pushtet

edhe pse jam drejtor i infrastrukturës, edhe këshilltar jam sepse ka filluar tash edhe itinerari i ri do të thotë prej Krushevcit në Prishtinë. Është edhe tjetra prej Obiliqit në Fushë Kosovë. Sa i përket pyetjes që e bëri ai me shkue te lagjja e tij, së pari është mirë me pyet veten ai se a ka qenë ndonjëherë në lagjen e tij përveç kur janë zgjedhjet me shku me marrë ndonjë votë. Ajo lagje tash atë e ka ndëshkuar dhe tash është qeverisja e re. Edhe pyetja tjetër është që nuk e di ku jeton z.Gashi, a jeton në Krushevc apo jeton në Prishtinë.

Enver Gashi – Z.Shalaku dhe juve të pranishëm dilni shikoni stacionet ku janë përpara dhe andej le të shkon autobusi dhe a ka udhëtarë apo nuk ka mbi 50 shtëpi, janë në atë pjesë që mbeten jashtë transportit publik, e juve ju qoftë për nder.

Fidan Ahmeti - Unë deshta me potencu që kërkesa ime e parë në Kuvend ka qenë transporti publik. Sigurisht sado që bëjmë politika të brendshme jemi të interesuar për me bë një zgjidhje afatgjatë për qytetarët, sepse fundja janë familjet tona. Fëmijët tonë udhëtojnë me transportin publik, edhe vetë jemi të interesuar me rregullu këtë pjesë njëherë e përgjithmonë ose për një periudhë afatgjatë. Mirëpo, është mirë pak me i'u përshtatë ligjeve dhe rregullave që mos të na kthehet prapësht e me u marrë 3,4 herë me një pjesë. Mendoj se seanca e jashtëzakonshme ka qenë jo e thirrur në mënyrë të rregulltë për atë arsye edhe nuk kam marrë pjesë, po flas individualisht si Fidan. Përndryshe, unë jam për me dhënë kontributin se 2,3 herë e kam potencue pjesën e transportit publik, jam i interesuar me dhënë kontributin sepse për atë e kemi marrë besimin prej qytetarëve si pozitë si opozitë me rregullu mirëqenien e qytetarëve. Për këtë arsye unë çdo herë jam i gatshëm çdo projekt që është në të mirën e qytetarëve, po me bë politikë se fundja nuk e ka një kuptim të gjithë me qenë pozitë, ose të gjithë opozitë. Mendoj se kjo është e mira, nuk ka njeri pa të meta, ju mund të bëni gabime dhe ne me i gjetë gabimet e juaja, përmirësime e gjëra të tilla, por çdo herë duhet me qenë në të mirën e qytetarëve. Është koha e fushatave ku mund të bëjë politikë secili, përndryshe unë jam për me dhënë kontributin çdo herë në çdo projekt që është në të mirën e qytetarëve.

Kryesuesi – Një diçka që na bashkon të gjithëve është nevoja që të ketë transport publik dhe kjo është një nismë që më mirë vonë se hiç, kështu që a është e mirë apo e keqe e vlerësojnë qytetarët. Pra, kërkohet të miratohet subvencionimi në nisje i 10 linjave, të transportit publik në Komunën e Obiliqit. Ky subvencionim do të bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, nga të hyrat vetanake në vlerë prej 0.75 centë për kilometër në nisje dhe kjo do ti kushtoj buxhetit të Komunës 27,147.31 centë në muaj ndërsa, në vit 325 mijë e 767 euro e 74 centë.

Kryetari – Subvencionimi i transportit publik është shumë i rëndësishëm për krejtë qytetarët e Komunës së Obiliqit. Ne po e bëjmë subvencionimin e transportit publik duke e përfshirë çdo lokalitet në transportin publik. Është e vërtetë se shumë lokalitete tona nuk kanë qenë të përfshira në transportin publik. Vetëm kjo pikë nuk është politike dhe kjo është shumë e nevojshme për të gjithë qytetarët e Komunës së Obiliqit. Pra, subvencionimi i transportit publik bëhet me të vetmen arsye që të përfshihet çdo lokalitet në transportin publik. Ne e kemi mbajtur një seancë të jashtëzakonshme dhe kemi marrë një vendim që ti votojmë linjat e reja dhe natyrisht se kemi biseduar, i kemi dëgjuar dhe jemi konsultuar me operatorët ekonomik. Mirëpo, një gjë duhet ta kenë parasysh se Komuna e institucioni nuk vendos për interesat e individëve, por për interesin publik dhe interesi publik është përfshirja e të gjitha fshatrave në transportin publik. Unë kam pasë takime të shpeshta me operatorët ekonomik që operojnë në Komunën e Obiliqit, por ata nuk janë me na tregu neve se qysh i bëjmë vijat sepse planin dhe itinerarin e bëjnë zyrtarët e Komunës, e bëjnë Komisionet siç e tha drejtori Svirca, janë formuar 2 Komisione njëri për krijimin e linjave dhe itinerareve dhe tjetri për subvencionime. Subvencionimi është për kilometër dhe jam i bindur se qytetarët nuk do të kenë më problem me transportin publik.

Linda Bektashi – Ne si grup parlamentar i LDK-së, sigurisht se kur është në të mirën e qytetarëve gjithmonë do të jemi pro, por kërkohet që kërkesat dhe ankesat tona të shqyrtohen. Kryetari po thotë se nuk janë ata që na tregojnë neve qysh me i bë vijat, por Kryetari duhet me pasë parasysh se ata operojnë që 30 vite dhe duhet me i pasë parasysh edhe kërkesat e tyre, mundësitë se qysh ata munden me shku

mëtuqje, kështu që Kryetar unë një kompani që e njohë nuk e di që ka qenë në takim me juve dhe nuk e di që janë të informuar për këtë punë.

Kryetari – Ne kemi pasë takime jo në hartimin e projektit, jo në hartimin e linjave. Nëse, mendoni që operatorët duhet me i përfshi në hartimin e projekteve është gabim. Ne i kemi dëgjuar kërkesat, ankesat dhe është një operator i Prishtinës, që vazhdimisht i dëmton, por ne fillimisht dojmë me stabilizue transportin publik me gjithëpërfshirjen e fshatrave, dhe me mendu se ai operatorë ekonomik që funksionon në Komunën e Obiliqit, a duhet me vazhdu më apo jo. Është e vërtetë se ai i ka 30 vjet që operon, por nuk është operator i Komunës tonë, nuk merrë licencë te ne prandaj ne duhet me u ndalë dhe me shiku se a duhet me vazhdu ai punën te na apo jo. Mirëpo, para se të ndalemi dhe të shikojmë se a duhet ai me vazhdu punën apo jo, ne duhet me rregullue transportin dhe gjithëpërfshirjen në çdo lokalitet, pa keqkuptime këtu, sepse nuk është vetëm operatori për të cilin e ke fjalën, por është edhe një operator tjetër i kemi thënë se është e pamundshme dhe është e paarsyeshme para qytetarëve dhe para ligjit ne me subvencionu fshatrat e Komunës së Vushtrrisë. Ne duhet me i subvencionu fshatrat tona sepse taksat tona janë dhe ne nuk kemi mundësi linjën që shkon për fshatin Stanovc, Lumin e madh edhe Gracë, por ne subvencionojmë fshatin Breznicë, Kozaricë dhe Baimoc. Besoj se secili prej jush ma kishit gjetë vërejtjen se qysh po i subvencionon fshatrat e Vushtrrisë, që besoj se kemi me pasë mirëkuptim. Natyrisht se ne do të shohim se a po funksionon apo jo, a duhet me bë një ndryshim apo rishikim dhe qysh tha edhe z.Gashi ka mundësi mos me u përfshi një lagje që duhet me u ndalë e me mendue se a është përfshirë apo nuk është përfshirë. Fillimisht e jona është që në çdo lokalitet me pasë transport publik.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryetar, edhe ne jemi të zgjedhur prej lokaliteteve dhe unë prapë po them ju përgëzoj për punën. Infrastruktura nuk i plotëson kushtet për Barilevë dhe Koskovik, po flas për fshatin Breznicë. Unë udhëtoj andej dhe kam jetue aty, i kam pastruar ato rrugë kur kam qenë drejtor Unë jam pro le të filloj dhe nëse, është marrë iniciativë për shembull me u përfshi edhe Grabofci dhe të gjitha fshatrat unë nuk e kam dyshimin te ju, se ju nuk keni me bë zgjidhje prapë për fshatin Breznicë. Mirëpo, infrastruktura rrugore është problem për autobusë me qarkullue për Koskovik dhe Barilevë. Ndoshta, duhet me mendu dhe rishiku, kështu që unë jam pro është një punë e madhe, është një subvencion i nevojshëm dhe i domosdoshëm, por duhet me pasë parasysh me rishiku këtë çështje.

Linda Bekteshi – E kam një pyetje për Kryetarin se nuk e kuptova mirë ose nuk e kuptova qartë, do të thotë linja që operon për Breznicë që kalon nga Stanovci nuk llogaritet në këtë subvencion, a është kështu sepse nuk munda të isha e qartë në përgjigjen tuaj.

Kryetari – Ke të drejtë ndoshta, nuk arrita me sqarue mjaftueshëm. Unë thashë linja që shkon prej Breznicës dhe delë në Stanovc me të drejtë ju kishit me thënë qysh i subvencionon ti 2 fshatrat e Komunës së Vushtrrisë, do të thotë Stanovci deri te Graca. Për shembull, jo ti por një asambleistë i joni kishte mund me thënë që pse nuk hyn për Baimoc sepse jo krejtë sikur unë e ti e Abdyrrahmani e dijmë se cila rrugë do ti bie tash për atje. Është mirë me fillue dhe nuk është koha e dimrit që kanë me pasë vështirësi. Unë jam pikërisht për me i ndihmue atyre operatorëve, që në kohët më të vështira iu kanë ndihmue qytetarëve tonë. Të gjithë ne e kemi krye shkollën e fakultetin me ata autobusë dhe natyrisht se e kemi të paktën një ndjenjë për ata dhe jemi për me iu ndihmue atyre, por më së shumti kjo është në interesin e gjithë qytetarëve me i përfshi të gjitha lokalitetet.

Enver Gashi – Unë sa kuptova nga Koskovikët vjen dhe hyn në pjesën e Barilevës, do të thotë njëjtë është si Barileva si Stanovci.

Kryesuesi – Nuk është njëjtë se në Barilevë janë një kilometër më së shumti.

Enver Gashi – Unë po flas në aspektin e territorit komunal, do të thotë është njëjtë.

Kryetari – Aty, e përfshin një pjesë të Prishtinës, e që nuk i bjen siç tha kryesuesi një kilometër më shumë, por me kriju linja të reja po krijohet edhe barrë për subvencionim. Ne kemi mendu dhe Komisioni e ka konstatuar se është pak më e lehtë dhe më e përbalueshme financiarisht, por kishte me qenë mirë sikur të kishim buxhet më shumë dhe me subvencionu më shumë linja të reja, natyrisht se kishte me qenë edhe më mirë. Mirëpo, për momentin këto janë mundësitë tona buxhetore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 18 vota, për dhe 2 vota ,abstenim morën vendim për miratimin e subvencionimit të transportit publik në Komunën e Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DEFZH-së, për bartjen e buxhetit të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026 dhe për një sqarim më të gjerë rreth kësaj fjalën ia dha drejtorit të DEFZH-së.

Besnik Krasniqi – Ne kemi bërë një kërkesë për bartjen e mjeteve, për me u alokue nga viti 2025 në vitin 2026 për projektin shëndetësia dhe mirëqenia sociale për ndërtimin e QKMF-së në qytetin e Obiliqit. Këto, mjete kanë qenë të pashpenzuara dhe ju i keni edhe në mënyrë tabelare të specifikuar dhe 3 mujorin e fundit. Neve, na është kërkuar që këto mjete ti alokojmë në projektin e QKMF-së, në qytetin e Obiliqit duke u bazuar në nenin 15 paragrafi 5, 6 dhe 8 të Ligjit nr.10/L-00 për ndarjen e buxhetit ku projektet e reja kapitale të nivelit lokal mund të shtohen me kusht që projekti kapital i tillë të financohet dhe balancet e pashpenzuara të të hyrave për vitet e kaluara të barten në këtë projekt.

Fjolla Nasufi - Pasi që drejtori i tha të gjitha e mbështesim këtë pikë.

Linda Bekteshi – Nuk kemi diçka rreth kësaj pike.

Kryesuesi – Pra, kërkohet të miratojmë bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026 në vlerë prej 384,449 euro, e 70 centë të cilat do të barten në programin dhe projektin shëndetësia dhe mirëqenia sociale, kod i buxhetor 730, nënprogrami shërbimet e shëndetësisë primare në projektin ndërtimi i QKMF-së në qytetin e Obiliqit.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës me 18 vota, për dhe 2 vota, abstenim morën vendim për bartjen e buxhetit të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës, për miratimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, pasi që i ka kaluar të gjitha procedurat sipas ligjit dhe fjalën i'a dha drejtorit për mbrojtje të mjedisit.

Rinor Kurteshi – Siç e cekët edhe ju kjo Rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara me dt.23.04.2026. Është mbajtur edhe debati publik dhe këto ndryshime janë të domosdoshme për përmirësimin e gjendjes së menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Obiliqit, prandaj, kërkohet nga ju që ta miratoni.

Fjolla Nasufi – Ne e mbështesim plotësim ndryshimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Linda Bekteshi – Nuk kemi diçka rreth kësaj pike.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës me 17 vota, për dhe 2 vota, abstenim morën vendim për miratimin e Rregullores për plotësim ndryshimin e Rregullores me nr.03 kthye për 2024 me të cilën është plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja nr.02 kthye për 2023 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe aprovimin e Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale për NPL “Kastrioti” SH.A.

Kryetari – Neve, na duhet një parcelë për NPL “Kastrioti” pasi që kësaj kompanie tashmë po i shtohet edhe Departamenti i mbledhjes së mbeturinave dhe shumë shpejtë do të shtohen edhe Departamente të tjera.

Kryesuesi – E ftoj drejtorin e DPUKP-së, të na informoj se ku gjendet kjo parcelë dhe a është gjithçka në rregull për të vepruar mëtutje.

Gazmend Krasniqi – Me kërkesë të Kryetarit parcela gjendet në Obiliqin e Ri në sipërfaqe prej 3,029 m² katror më saktësisht në parcelën 815 /1 që është afër te kthesa rruga që shkon për Palaj, përballë do të thotë është afër shkollës teknike që ka qenë përpara.

Fjolla Nasufi – E mbështesim këtë pikë të rendit të ditës pasi që drejtori i dha arsyet e nevojshme.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Jemi te një pikë një çështje shumë e rëndësishme për Komunën tonë, për një Ndërmarrje ku çdo ditë kryhen shërbime jetike për banorët tonë. Kjo Ndërmarrje daton që nga viti 2021 dhe mos të harrojmë se çdo ditë punëtorët e kësaj Ndërmarrje ndihmojnë në uljen dhe parandalimin e

sëmundjeve të ndryshme. Pra, të nderuar anëtarë të Kuvendit në një Obiliq, ku ajri është shumë i ndotur punëtorët e kësaj Ndërmarrjeje çdo ditë kryejnë shërbime duke menaxhuar mbeturinat. Po ashtu, kujdesen për parqet, rrugët dhe ndriçimin publik. Këta, punëtorë po ashtu reagojnë edhe ndaj emergjencave pas vërshimeve për të pastruar rrugët, heqjen e borës dhe punojnë në kushte shumë të vështira siç janë: temperaturat e ulëta, temperaturat e larta, në borë dhe në shi. Mirëpo, po ashtu janë të ekspozuar edhe para shumë rreziqeve si aksidentet në trafik sepse derisa ne po debatojmë tani në këto momente në këtë ambient komod ata janë nëpër rrugë duke mirëmbajtur dhe duke u kujdes për mirëqenien e qytetarëve tonë. Andaj, të nderuar kolegë ju ftoj që ta mbështesni këtë kërkesë sepse është interes i drejtpërdrejtë i qytetarëve tonë. Kjo Ndërmarrje duhet të mbështetet në vazhdimësi dhe të ngritet, e jo për ta shkatërruar.

Kryesuesi – Për qe është e rëndësishme për mbështetje të fushave të ndryshme nuk ka diskutim dhe ka filluar nisma që besoj se do të përmirësohet shumë gjendja e kësaj Ndërmarrjeje, aq më tepër kjo Ndërmarrje edhe pse është themeluar në dokumentet e saj nuk kemi gjetë ndonjë dëshmi që ka ndonjë pronë që ka qenë dashtë në rastin e themelimit të saj ta ketë edhe pronën. Mirëpo, falë përkushtimit të Ekzekutivit është bërë kjo mundësi dhe sigurisht se të gjithë ne do ta mbështesim sepse është një gjë shumë e mirë, aq më tepër për faktin se do të shtohen edhe shërbimet e saj.

Goran Dancetovic – Konsideroj se kjo Ndërmarrjeje, e cila ka këtë veprimtari është e domosdoshme për Komunën e Obiliqit, por kryesisht këto Ndërmarrjeje nëpër vendet e botës janë jashtë qytetit, e jo në qendër të qytetit.

Kryesuesi – Parcela në fjalë nuk është në qendër të qytetit, kështu që i plotëson ato kriteret për të cilat të gjithë ne e kemi konsideruar si të tillë.

Goran Dancetovic – Unë sa munda të kuptoj ajo është te ish qendra teknike e shkollës, që është dikund rreth 300-400 metra, afër nesh këtu ku jemi.

Kryesuesi – Parcela gjendet te vendi i quajtur Obiliqi i Ri me kulturë tokë bujqësore, kullosë e klasës së parë në sipërfaqe prej 2,944 m² dhe kulturë tokë ndërtimore, shtëpi, ndërtesë në sipërfaqe prej 85 m² që gjithsejt bëjnë 3,029 m² zona kadastrale Obiliq, numri i parcelës kadastrale P-72614055-00815-1.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 18 vota, për dhe 2 vota kundër morën vendim për miratimin e Propozimvendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale për NPL “Kastrioti” SH.A.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Raportin financiar të shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2026.

Fjolla Nasufi – E falënderoj drejtorin për transparencën gjatë materialit që e kemi rishikue, ka qenë gjithçka në rregullë, kështu që ne e mbështesim raportin financiar për këtë periudhë.

Linda Bekteshi – Nuk kemi diçka rreth kësaj pike.

Goran Dancetovic – Ju lutem për seancën tjetër të na përktheni raportin 3 mujor.

Kryesuesi – Do të përkushtohemi në atë drejtim. Ju e dini se raporti nuk votohet dhe ne e falënderojmë Ekzekutivin për nivelin e përgjegjësisë dhe transparencës.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës për iniciimin e procedurës për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal të Obiliqit, për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në nivelin komunal dhe për një shpjegim më të gjerë fjalën ia dha drejtoreshës së DSHMS-së.

Albertina Dedinca – Duke u bazuar në Ligjin për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij konkretisht neni 2 paragrafi 1.3, 1.5 si dhe neni 10 paragrafi 2 si dhe në Ligjin për shëndetësi konkretisht neni 20 që parashehë organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në Komuna, propozoj iniciimin e procedurës për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në Komunën e Obiliqit, përmes krijimit të një ambulance specialistike. Të nderuar kolegë, Obiliqi nuk është një Komunë si të tjerat, është një zonë me ngarkesë të lartë mjedisore ku qytetarët tonë përballen çdo ditë me pasoja direkte në shëndetin e tyre. Për këtë arsye qasja në shërbimet specialistike do të duhej të ishte një e drejtë themelore. Me autorizimin që sot Kryetari e merrë këtu, realizimi i këtij projekti parashihet të bëhet në bashkëpunim me Komunën e Fushë

Kosovës, Ministrinë e Shëndetësisë, QKUK-në, Institutin e Mjekësisë së Punës duke e bërë kështu këtë projekt të kordinuar institucional dhe të qëndrueshëm. Në kuadër të këtij projekti parashihen këto shërbime: pulmologjia, kardiologjia, radiologjia, endokrinologjia, gjinekologjia, pediatria, psikologjia kimike, mjekësia e punës, fizika bërthamore, fiziatra, biokimia kimike. Andaj, të nderuar asambleistë sot e kemi mundësinë për të marrë një vendim që prekë drejtpërdrejtë në shëndetin e qytetarëve tonë, kështu që ju ftoj dhe ju lus që ta mbështetni këtë inicim.

Fjolla Nasufi – Ne si grup e mbështesim iniciativën për avancimin e shërbimeve shëndetësore.

Linda Bekteshi – Sigurisht se kur është në të mirën e qytetarëve gjithmonë e mbështesim.

Kryetari – Të nderuar asambleistë, kjo nismë nuk është një nismë e lehtë prandaj unë fillimisht kërkoj nga secili prej juve mbështetjen në këtë rrugëtim sepse nuk është e lehtë, por është shumë i nevojshëm për qytetarët e Komunës së Obiliqit, dhe për qytetarët e Komunës së Fushë Kosovës. Në bashkëpunim me Ministrinë e shëndetësisë gjithmonë dhe çdo herë pa e dëmtuar buxhetin e Komunës tonë, por vetëm duke i sjellë qytetarëve tonë një shërbim më afër e shërbime më shumë në shëndetësi, prandaj kërkoj nga secili prej juve të na ndihmoj në këtë rrugëtim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 17 vota, për dhe 2 vota ,abstenim morën vendim për miratimin e inicimit të procedurës për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor në nivelin komunal.

Labinot Mirena – Kryesues, deshta me ta bë një pyetje qysh i blejte këta kolegët tonë që po votojnë mirë sepse kur po votoj unë edhe z.Abdyrrahman po thojnë jeni të shitur, vetëm dua të di me çka u shitën këta.

Kryesuesi - Nuk kisha dashtë me u lëshu në këtë temë.

Muhamet Preniqi – Së pari kryesues dhe Kryetar duhet me i'a tërheqë vërejtjen këtij asambleisti tuaj që më heret na krahasoi me listën serbe. Unë nuk jam kundër listës serbe, por z.Labinot kishte me qenë më mirë të merret me mbeturina sepse na kanë mbulue mbeturinat deri në vesh.

Kryesuesi – Për neve, konsiderohen asambleistë tonë të gjithë asambleistët e qytetarëve të Komunës së Obiliqit dhe ju lus që secili të qëndroni në pikat e rendit të ditës.

Muhamet Preniqi - Një mbjellje të flokëve z.Abdyrrahman.

Kryesuesi - Ju lus për qetësi, askush nuk është në shitje dhe ju lus të mos përdorni këso termesh.

Linda Bekteshi - Thashë edhe më heret ne si grup i LDK-së, kur është në të mirën e qytetarëve gjithmonë do të jemi pro.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës për kompensimin e Komisionit Komunal të aksionarëve të NPL "Kastrioti" SH.A. Shkresën nga Ministria e Ekonomisë e keni pranuar, kërkesa për subvencionimin është bërë njëjtë sikurse që është bërë edhe në mandatet e kaluara, por ata kanë konsideruar se ky vendim nuk është në përputhje me Ligjin për Nënmmarrjet Publike dhe neve, na mbetet që ta shfuqizojmë atë. Ndërsa, i mbetet aksionarit së bashku me Ndërmarrjen që të gjejë metodën e pagesës së Komisionit të aksionarëve.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, e lexova vendimin dhe sa kuptova unë është thënë që pagesën me bartë te Komunitat dhe në fund ka shkru Komuna e Prizrenit, aq profesionistë që kishte qenë. Mendoj se ne po e shfuqizojmë ashtu qysh e inicua edhe në mbledhjen e KPF-së, por i mbetet Komunës me gjetë një zgjidhje me kompaninë sepse kjo është jashtë kompetencave të Ministrisë.

Kryesuesi - Pikërisht këtë edhe e thashë në shpejgimin tim dhe kështu do të veprohet.

Enver Gashi - Unë deshta një vërejtje të përgjithshme që kur të përgatiten pikat e rendit të ditës të konsultoheni pak edhe me ligjin sepse u mbytëm me shfuqizime, 3 sot po bëhen.

Kryesuesi – Z.Gashi, nëse kishte me thënë znj.Dorentina, që është për herë të parë dhe disa anëtarë tonë që këtu, janë për herë të parë nuk më ishte dukë çudi, por nëse thua ti kjo më duket pak pa lidhje sepse ju e dini vetë se vetëm në seancën e fundit të mandatit të kaluar i kemi shfuqizue 4 vendime, e 12 vite mandat që keni pasë që do të konsiderohej që keni mjaftueshëm dije në atë drejtim. Ju e dini gjendjen e sektorit të Kuvendit, qysh e keni lënë, me i thënë sektor i Kuvendit që e kemi vetëm znj.Zeneli që merret me secilën punë. Më heret ka qenë një asistent që është ardhë vetëm me bë fotografi dhe është paguar bukur mirë

sepse asnjë ditë nuk është ardhë në shërbim të sekretarisë së Kuvendit, e as anëtarëve të Kuvendit. Tash, kanë ndryshu disa gjëra dhe unë e pranoj se bëjmë gabime, por gabime nuk bëjmë për me i dhënë tendera familjarëve tonë. Kjo, është një diçka që tregon transparencë dhe jemi gjithmonë të gatshëm edhe kur ka ndonjë gabim e pranojmë, se ky gabim është një prej gabimeve që e kam bërë unë vetë. Prandaj, nuk konsideroj gabim derisa e sjellë para juve, me kërku mirëbesimin tuaj dhe me shfuqizue vendimin.

Linda Bektoshi – Pasi që kam qenë drejtoreshë e administratës dua ta sqaroj këtë çështje edhe ne e dijmë se znj.Azize është vetë dhe ne kur e kemi bërë organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunë, Ministria nuk na ka leju me qenë pjesë e Kuvendit. Edhe ne kemi pasë dëshirë znj.Azize, me pasë një ekipë që punon veç për Kuvend, por Ministria nuk na ka leju.

Kryesuesi – Ndërsa, Ministria e njejtë ju njoftoj juve se së shpejti do të bëjë miratimin e sektorit të Kuvendit, që së paku do të ketë 8 anëtarë, dhe atëherë kemi të drejtë secili prej neve me kërku llogari ndaj joprofesionalizmit sepse ne nuk jemi të gjithë të dijshëm. Unë ndoshta di diçka nga drejtimi i drejtësisë, por nuk di nga ekonomia, kështu që kush i ka provuar këtp gjëra i din shumë mirë.

Abdyrrahman Krasniqi – Unë e kam pak një kritikë të vogël të kisha kërku me lirue z.Bajram dhe z.Enver prej votimit kur janë shfuqizimet se pak edhe mosha ndërsa, ne kemi kondicion i votojmë.

Enver Gashi – Po iu përgjegjem edhe juve edhe z.Krasniqi, se z.Krasniqi me qenë i mirë ish me grup të vetin dhe nuk i prehet dom sa i përket asaj se unë e z.Bajram a kush do të jemi këtu, atë e vendos vota. Ne kemi dalë me votë z.Krasniqi, jemi matë unë e ti dhe e di ku je ti e ku jam unë.

Bajram Hashani – Seriozisht nuk ka kuptim z.Abdyrrahman t'u kisha lutë kur ma përmendë emrin të kesh kujdes, t'u kisha lutë mos ma përmendë emrin panevojë kur nuk të thirri apo nuk të them diçka, ta kesh të qartë këtë sot e gjithmonë.

Abdyrrahman Krasniqi – Fillimisht këta e kanë uzurpue LDK-në, realisht dhe këta janë ata që vendosin se kush është LDK e kush nuk është LDK, edhe këtu po e potencojnë shumë herë. Z.Labinot e bëri një kërkesë më heret dhe këta kanë thënë se ne kur i kemi votu prej fillimit vendimet e mira, në shërbim të qytetarëve kanë thënë jo keni bërë marrëveshje dhe tash po delë që edhe këta po i votojnë krejtë vendimet dhe po e ndjekun politikën tonë. Atëherë, unë e kam si kritikë ose sugjerim mos e uzurpo, lëshone LDK-në, le ti mbetet popullit LDK-ja, mos na kritikoni neve edhe atëherë ne bashkëpunojmë, ne i votojmë. Unë jam për qytetarët dhe unë i votoj vendimet e mira. Unë e bëra një kritikë te Kryetari dhe e bëra si kërkesë te transporti dhe kur nuk është në shërbim që mendoj se duhet të bëhet plotësim ndryshimi unë e bëjë, por jo ti me vendos, jo Enveri.

Kryesuesi – Z.Krasniqi dhe të gjithë ju, kisha lutë prej këtij momenti të qëndroni në pikat e rendit të ditës.

Fidan Ahmeti – Ju kisha lutë në gjëra personale mos u lëshoni, mos me bë krahasim si kolegu më heret që janë të papranueshme për ne. Edhe një gjë duhet ta dijnë në daç grupi jonë në daç grupi i juaj se unë kam shumë shokë të shpirtit që janë në opozitë në këtë rast duhet me u mësue me i kuptue njerëzit që mendojnë ndryshe, në daç lidhe me politikë, në daç me fe sepse ka njeri që nuk falet por është djalë, burrë shumë i mirë dhe anasjelltas. Pra, ka njeri që është në LVV që është shumë djalë apo burrë shumë i mirë. Edhe një vërejtje kryesues rri pak neutral, je kryesues i të gjithëve, e ke pasë shembullin znj.Vlora ish kryesuese qysh ke pasë drejtë ti kam pasë edhe unë. Unë vetëm si këshillë po ta japë e ti tash e ke atë tënden vazhdoje njejtë por si këshillë po ta japë rri kryesues i Kuvendit i të gjithëve, përndryshe unë si Fidan ju lus edhe njëherë të mos lëshohemi në gjëra personale dhe meqë, tash janë zgjedhjet mund të bëjmë politikë, edhe fushatë, por mos të lëshohemi në gjëra që nuk na kanë hije sepse fundja jemi shembull i qytetarëve.

Kryesuesi – Pajtohem z.Ahmeti, me një pjesë të asaj megjithatë, mua nuk mund të më thuhet se jam vetëm kryesues sepse jam edhe anëtar i Kuvendit Komunal, i votuar nga një pjesë, nga disa që na kanë bojkotuar seancën, kështu që unë do ta luaj rolin tim edhe si anëtar i Kuvendit të Komunës edhe gjithsesi i kam mendimet e mia. Pajtohem plotësisht që mos me kalu në personale, mos përdorni fjalor banal se në fund të fundit ka edhe konsekuenca në këtë drejtim, kështu që të jemi sa më të saktë në pikat e rendit të ditës sepse po votohen vendime të mira. Sa i përket shfuqizimit të vendimeve, ne vetëm po e ndërmarim një akt

shumë ligjor që duhet ta ndërmarrim, por sikur ti kishim fshehtë dhe të mos i kishim sjellë me i shfuqizu në këtë rast atëherë, kishte me qenë shkelje ligjore.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 17 vota, për 1 votë, kundër dhe 2 vota, abstënim morën Vendim për Shfuqizimin e vendimit nr.01-060/01-6641/26 i dt.06.03.2026 për kompensimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Kompanisë NPL “Kastrioti” SH.A.

Kryesuesi – E kemi edhe shfuqizimin e vendimit për kompensimin e Komisionit Komunal të kompanisë KRM “Pastrimi”.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës me 17 vota, për 1 votë, kundër dhe 2 vota, abstënim morën Vendim për Shfuqizimin e vendimit nr.01-060-6640/26 të dt.06.03.2026 për kompensimin e Komisionit Komunal të Kompanisë KRM “Pastrimi”.

Pika 11 e rendit të ditës

Linda Bekteshi – Unë e kam një pyetje për Kryetarin ose për Drejtorinë e kulturës, disa grupe, disa OJQ na kanë kërkuar që të ngritim këtë pyetje në Kuvend, që nuk i’u kanë ndarë mjete nga subvencionet që ka qenë thirrja publike. Kryetar a mund të na sqarosh se cilat kanë qenë kriteret ose cila ka qenë arsyeja që disa klube nuk kanë marrë subvencione, apo i keni shikuar kësaj here politikisht edhe pse kisha kërku që në këto raste sidomos kur bëhet fjalë për grupet sportive, të mos shikohen politikisht.

Kryesuesi – Ju njoftoj se në rast se nuk merrni përgjigje në këtë moment për pyetjet që i bëni ka mundësi tjera, të përgjigjeve, edhe me shkrim edhe në seancën e ardhshme, kështu që secili prej jush mund të deklarohehi për pyetjet që bëhen.

Kryetari – Ish-drejtoresha e din shumë mirë se ka qenë një Komision aty dhe nuk e di për besë se cilat kanë qenë kriteret dhe mua nuk më takon me ditë çdo detaj, sepse dikush më herët duke e ditë çdo detaj dikend e ka dërgu në burg, ti e din dhe sot atë ditë janë të suspenduar 2 zyrtarë. Tash, a kanë faj zyrtarët apo jo secili Komision e mbanë përgjegjësinë për veten. Nëse, ti mendon dhe e gjen veç dikush që është favorizu politikisht është mirë me folë publikisht cili është favorizu politikisht, që nuk besoj se ka edhe nuk duhet me pasë kurrë sepse ka kaluar ajo kohë kur njerëzit janë favorizuar politikisht.

Linda Bekteshi – Unë nuk e thashë qysh po thotë Kryetari, unë vetëm e bëra pyetjen nuk akuzova pse vetëm thashë a i keni shikuar. E kam edhe një pyetje për Kryetarin, e ke pasë një takim me Këshillat e fshatrave dhe atyre lokal, i’u ke premtuar se do të bësh pagesën për ata Kryetar, dhe mua më intereson me ditë se kryesuesi e din që ne nuk kemi pasë formë ligjore, as nuk kemi pasë mundësi me i paguar. Unë kisha pasë dëshirë me ditë se cila është forma që do ti paguani ata Kryetar.

Kryetari – Unë kam biseduar me ata dhe kishte me qenë mirë me bë një pagesë për ata, por duhet me i gjetë format dhe mënyrat ligjore qysh ne mund të arrijmë deri te pagesa e tyre. Unë nuk jam ithtar i asaj me thënë se nuk ka kurrfarë mënyre se qysh ne me i pagu. Tash nuk e di a jemi mundu a nuk jemi munduar, por po na dalin shumë punë për shembull ne këtu, e votuam subvencionimin e transportit që ndoshta, ju kishit thënë nuk ka mundësi edhe nuk bëhet edhe për KRM “Pastrimi” për me kalu në menaxhimin tonë keni thënë nuk bëhet, nuk na lejon ligji, por bëhet edhe na lejon ligji. Unë jam ithtar për me i paguar ata njerëz sepse ata njerëz janë aktivistë që punojnë mirëpo, formën ligjore fillimisht na tregon Zyra ligjore pastaj ne e sjellim në Kuvend, që besoj bashkë kemi me votu.

Muhamet Preniqi – Kryesues, një sqarim pse nuk është në rend dite pika 8 që më duket e kalove subvencionimi i klubit futbollistik të KEK-ut.

Kryesuesi – Subvencionimet dhe kërkesat tjera, janë trajtuar në mbledhjen e KPF-së, që i janë rekomanduar Drejtorive të merren me procedurat e subvencionimit, kështu është vepruar vazhdimisht z.Preniqi.

Muhamet Preniqi – E kam një pyetje për Kryetarin, kam ankesa nga ndërtuesit, bizneset në Obiliq me na sqaru Kryetari, për çfarë arsye pezullohen lejet qe 6 muaj ditë prej se keni ardhë në pushtet nuk ka marrë leje ndërtimi asnjë kompani, normal ato që i plotësojnë kushtet. Obiliqi ka nevojë për zhvillim, e jo për këso bllokada, a mund të na tregoni a keni lëshuar ndonjë leje deri sot, çfarë letra keni lëshuar dhe çka keni krye deri sot qe 6,7 muaj.

Kryetari – Pyetja shkon më shumë për drejtorin e urbanizmit dhe unë nuk e di sa leje janë lëshuar, veç e di që ligjin nuk bën me shkelë. Z. Muhamet, unë shumë mirë po e di ku po aludon por edhe ata e dijnë se në atë formë pa e rishikuar edhe një herë projektin e tyre ata nuk mund të marrin leje sepse nuk mund drejtori me shku në burg për atë punë. Ata kanë marrë premtime që i'u lëshohet leja prej më herët por në atë formë drejtori dhe ligji, po thotë që nuk mund të merrë leje. Këtu, mos të keqkuptohemi se nuk ka kurrfarë bllokade, por ka bllokadë në njëfarë forme me hartat zonale sepse ne konsiderojmë se koeficienti në disa pjesë është shumë i ulët, që në fakt paraqet kogja problem për vetë ndërtuesit. Këtë, sigurisht se kemi me rishiku dhe drejtori mund të na tregoj në detaje pasi që je ashtu i interesuar.

Besnik Krasniqi – Sqaron se është Ligji i hartave zonale që është bërë pikërisht në qeverisjen e juaj që e keni pasë më herët dhe ne thjeshtë jemi duke e implementuar. Asnjë kompani deri tash nuk i është ndalë leja nëse, i ka plotësue kushtet dhe asnjë kompani deri tash nuk ka marrë as nuk do të merrë leje nëse, nuk i ka plotësuar kushtet. Po ashtu, nuk mund të jetë në bonusin 10 % edhe që ia jepë Komunës, dhe prapë me hy me ndërtuar po në atë parcelë sepse ajo është e Komunës, dihet distanca, dihet përqindja e gjelbërimit, dihet sa është koeficienti për hapësirë prandaj, edhe nuk janë lëshuar leje deri tash.

Muhamet Preniqi – Ne jemi dakord zbatoni hartat zonale, lëshoni lejet dhe leni njerëzit të punojnë.

